



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. 176 Prot
Shkodër, më 06 . 01 .2022



TË NDRYSHËM & TË BARABARTË

Nr. 02 Prot
Shkodër, më 06 . 01 .2022

**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI
PËR VAZHDIMIN DHE OFRIMIN E MODELEVE TË REJA E TË INTEGRUARA TË
KUJDESIT DHE EDUKIMIT PËR FËMIJËT PËRMES MBËSHTETJES SË
PUNËSIMIT DHE FUQIZIMIT TË PRINDËRVE**

E lidhur sot në Bashkinë Shkodër, me datë ___/___/2022, ndërmjet palëve si më poshtë vijon:


Bashkia Shkodër, përfaqësuar nga Kryetarja e Bashkisë Shkodër, zj. Voltana Ademi, madhor dhe me zotësi juridike të plotë për të vepruar, adresë: Rr. “13 Dhjetori”, Nr.1, Shkodër, këtij e tutje e cilësuar si “Bashkia”

dhe

Organizata “Të Ndryshëm & Të Barabartë”, me NIPT K42324004S, regjistruar me vendimin Nr. 177, datë 17/05/2004, të Gjykatës së së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me seli në: Rruga “Fortuzi”, Godina 24, H.4, Ap.4, Tiranë Shqipëri, përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv, Znj. Mariana Meshi, në vijim e cilësuar si “**Organizata**”.

Baza ligjore :

- Kjo marrëveshje bazohet në:
- Ligjin nr. 139/2015, “Për vetqeverisjen vendore” i ndryshuar;
- Ligjin nr. 7850 datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar;
- Ligjin nr. 8788 datë 07.05.2001 “Për organizatat jofitimpruese” i ndryshuar;
- Ligjin nr. 10347, datë 04.11.2010 “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës”;



- Ligjin nr. 69/2012, për “Sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar;
- Ligjin nr. 9355, datë 10.03.2005 për “Ndhmën dhe shërbimet shoqërore” të ndryshuar,
- Ligjin nr.9887, datë 10.3.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” të ndryshuar;
- VKM nr.632, datë 04.10.2004 për miratimin e dokumentit për “Politikat e Decentralizimit në Sektorin e Arsimit Parauniversitar” ;
- VKM nr. 866, datë 24.12.2019, për “Miratimin e Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2020-2023 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj” ,
- VKM nr.465 dt.03.07.2019 “Për masat për mbrojtjen e fëmijëve nga aksesit në përmbajtje të paligjshme dhe/të dëmshme në internet”;
- VKB nr. 84 datë 20.12.2018 “Për miratimin e Planit Social të Bashkisë Shkodër”.

NENI 1

OBJEKTI

Objekt i kësaj marrëveshje bashkëpunimi midis Bashkisë dhe Organizatës është bashkëpunimi për vazhdimin dhe qëndrueshmërinë e **Alternativës së Përkujdesit**, për përkujdesjen dhe mbështetjen e fëmijëve të nënave viktime të trafikimit dhe dhunës në familje, pas mbarimit të orarit zyrtar të kopshteve dhe shkollave nga e hëna deri të premten, edhe ditën e shtunë gjithë ditën.

NENI 2

QËLLIMI I MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT

Qëllimi i marrëveshjes së bashkëpunimit është të përcaktojë fushat dhe mënyrat e bashkëpunimit mes palëve për të siguruar funksionimin, qëndrueshmërinë e modelit të kujdesit dhe edukimit të fëmijëve, si dhe mbështetjen e fuqizimit të prindërve, duke përdorur kapacitetet dhe mundësitë që jep organizata në përputhje edhe me reformën e decentralizimit, reformën territoriale/administrative dhe atë të shërbimeve shoqërore.

Ky shërbim synon t’u vijë në ndihmë fëmijëve të grave të mbijetuara të dhunës dhe të trafikimit, të cilët për shkak të mospërputhjes mes orareve të punës së prindërve dhe orareve zyrtare të qëndrimit të tyre në kopshte e shkolla dhe për shkak të mungesës së mbështetjes nga rrethi familjar i prindërve, rrezikojnë ose vuajnë neglizhimin, kequshqyerjen dhe mungesën e përkujdesit.



Organizata synon ta realizojë këtë nëpërmjet mbështetjes dhe vazhdimit të **Alternativës së Përkujdesit**, e cila konsiston në zgjatjen e orarit të kopshtit dhe hapjen e alternativës ditën e shtunë për fëmijët që shkojnë në alternativën e kujdesit brenda ambienteve të Qendrës Ditore që funksionon pranë Shtëpisë së Fëmijës 0-5 vjeç.

NENI 3

PËRFITUESIT

Përfitues të drejtpërdrejtë të kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi do të jenë 7-8 fëmijë nga familje me prindër/nëna të mbijetuara të trafikimit dhe dhunës në familje dhe prindërit e tyre.


Palët në këtë marrëveshje bashkëpunimi janë përfitues jo të drejtpërdrejtë të kësaj marrëveshjeje në masën që veprimet dhe detyrimet e përcaktuara në këtë marrëveshjeje bashkëpunimi kontribuojnë në arritjen e qëllimeve dhe misionit të tyre për kujdesin për fëmijët dhe grupet vulnerabël – viktimat e dhunës në familje dhe viktimat e trafikimit.

NENI 4

ROLET DHE PËRGJEGJËSITË E PALËVE

Bashkia Shkodër merr përsipër:

- Një punonjës i bashkisë shërben si pikë kontakti për zbatimin e kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi dhe pikës së kontaktit i jepet mbështetja e duhur për të realizuar detyrat sipas kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi.
- Në ambientet e Qendrës Ditore që funksionon pranë Shtëpisë së Fëmijës 0-5 vjeç dedikohet një ambient i përshtatshëm për Alternativën e Kujdesit duke vënë në dispozicion minimumi dy dhoma dhe tualetin për qëndrimin dhe ushqimin e fëmijëve pas orarit të mbylljes së kopshtit si dhe ditën e shtunë;
- Në përcaktimin e kriterëve të përzgjedhjes së fëmijëve përfitues të Alternativës së Kujdesit përfshihet një punonjës i Bashkisë, specialist i Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik;
- Punonjës të bashkisë Shkodër/ Drejtoria e shërbimeve sociale, strehimit dhe shëndetit publik përfshihen në monitorimin dhe/ose inspektimin e alternativës së kujdesit në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- Një punonjës i bashkisë, specialist i mbrojtjes së fëmijëve do të marrë pjesë në vlerësimin individual të progresit për nënat dhe fëmijët përfitues të projektit që do të zhvillohen në



bashkëpunim me menaxherët e rasteve, për të vlerësuar përfitimin e familjes dhe individit nga shërbimet.

Organizata “Të Ndryshëm & Të Barabartë” merr përsipër:

- Fondet e nevojshme nëpërmjet donatorëve të ndryshëm për funksionimin e plotë të shërbimit alternativ të kujdesit të fëmijëve.
- Mobilimin dhe pajisjen e përshtatshme dhe të vazhdueshme të ambienteve të Alternativës së Përkujdesit.
- Mbulimin e pagesës së dy punonjësve (mësuese kryesore/mësuese ndihmëse), nga e hëna në të premte (në varësi të nevojave të nënave) dhe ditën e shtunë ora 06.00 – 18.00.
- Mbulimin e kostove të mjeteve didaktike që do të përdoren nga fëmijët që do të frekuentojnë alternativën.
- Mbulimin e transportit të fëmijëve.
- Të ofrojë trajnime për rritjen e kapacitetit të stafit që do të punojë në alternativat e përkujdesit të fëmijëve.
- Monitorimin ditor të aktivitetit të Alternativës së Përkujdesit në lidhje me shërbimet që ofrohen aty:
 - ◆ Përkujdesja dhe mbikqyrja e fëmijëve
 - ◆ Higjena dhe Shëndeti
 - ◆ Ushqimi dhe ushqyerja
 - ◆ Mbështetja për shkollën/detyrat e shtëpisë
 - ◆ Mbështetja emocionale dhe mësimi i sjelljeve pozitive sociale
 - ◆ Lojrat
 - ◆ Informimi i nënës dhe konsultimi me të lidhur me kujdesin për fëmijën
 - ◆ Observimi i sjelljeve të fëmijës dhe raportimi i dyshimeve për neglizhim, abuzim apo ekspozim tek dhuna
 - ◆ Vlerësimi dhe mbështetja psikologjike dhe mjekësore
- Pikës së kontaktit nga bashkia si dhe çdo punonjësi të përcaktuar prej tyre u jepet informacion i plotë dhe transparent dhe u sigurohen kushte për pjesëmarrje dhe vendimmarrje në zbatim të kësaj marrëveshjeje;
- Punonjës të organizatës dhe organizatës partnere në zbatim kontribuojnë në zbatimin e marrëveshjes;
- Vendosija e kriterëve të përzgjedhjes dhe përzgjedhja e stafit të alternativës bëhet në bashkëpunim me palët në marrëveshje;
- Autoriteteve inspektuese apo monitoruese të bashkisë u jepet akses i duhur në përputhje me legjislacionin në fuqi;



- Bashkëpunëtorë dhe donatorë të organizatës marrin informacionin e duhur dhe u qaset për të siguruar vazhdimin e shërbimit;
- Prindërit e fëmijëve mbështeten nëpërmjet programeve të organizatës për të rritur aksesin e tyre në tregun e punës dhe rritur të ardhurat;

NENI 5

PËRDORIMI I INFORMACIONIT DHE KONFIDENCIALITETI

Palët do të përdorin informacionin e marrë sipas kësaj marrëveshje bashkëpunimi vetëm për qëllim të ushtrimit të funksioneve të tyre ligjore, dhe vetëm brenda kuadrit të kësaj marrëveshje bashkëpunimi.

Përgjatë kohëzgjatjes së kësaj marrëveshje bashkëpunimi dhe pas përfundimit të saj, pa asnjë kufizim në kohë apo në vend, palët do të mbajnë konfidencial çdo informacion apo dokument, të shkëmbyer mes tyre lidhur me këtë marrëveshje bashkëpunimi, aktivitetin, funksionimin, financat e secilës palë, dhe në përgjithësi çdo informacion apo të dhënë me të cilën palët janë njohur apo u është bërë e ditur për shkak të kësaj marrëveshje bashkëpunimi.

Palët do të ushtrojnë të gjithë kujdesin e arsyeshëm për të parandaluar rrjedhjen e informacionit tek çdo person juridik apo fizik i pa-autorizuar për të marrë këtë lloj informacioni, me përjashtim të rasteve kur ky informacion kërkohet për shkak të kërkesave të ligjit. Në rast të detyrimit për të dhënë te palë të treta, çdo lloj informacioni dokumenti apo të dhënë, për shkak të kërkesave të ligjit, do të kërkohet miratimi paraprak me shkrim i përfaqësuesve respektiv të secilës palë.

NENI 6

RUAJTJA, PERPUNIMI DHE PERDORIMI I TE DHENAVE PERSONALE

Palët bien dakort se për efekt të kësaj marrëveshje bashkëpunimi, në rast se do të mbledhin dhe përpunojnë të dhëna personale, do ta bëjnë këtë në përputhje të plotë me parashikimet e ligjit nr.9887, datë 10.3.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

Palët bien dakort dhe garantojnë respektivisht njëra-tjetrën se të dhënat personale të rinjve apo çdo personi që do të përfshihet në shërbimet/projektet e zbatuara nga palët në kuadër të kësaj marrëveshje bashkëpunimi, do të mblidhen, ruhen dhe përpunohen me anë të mekanizmave



teknologjike dhe në përputhje me parashikimet e ligjit nr.9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” të ndryshuar.

Palët bien dakort dhe garantojnë respektivisht njëra-tjetrën se nuk do të përdorin apo bëjnë publike të dhënat personale të mbledhura për efekt të zbatimit të kësaj marrëveshje bashkëpunimi apo çdo marrëveshje që do të lidhet në vijim midis palëve, në zbatim të saj, në ndonjë mënyrë që mund të çënojë të drejtat e fëmijëve, të rinjve apo çdo personi tjetër, apo detyrimet sipas ligjit nr.9887, datë 10.3.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” të ndryshuar.

Palët bien dakord se publikimi i fotove apo videove të bëra gjatë zbatimit të kësaj marrëveshje bashkëpunimi do të bëhet vetëm me konsensus të të dyja palëve. Nuk do të publikohen foto të cilat nuk janë dinjitoze.

NENI 7

PARIMET E MARRËVESHJES

Parimet kryesore të kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi janë parimet e përcaktuara në legjislacionin për të drejtat e fëmijëve në fuqi, e drejta për jetë dhe zhvillim, interesi më i lartë i fëmijës, mbrojtja nga diskriminimi, pjesëmarrja, mbrojtja e konfidencialitetit dhe privatësisë.

NENI 8


PERSONAT E KONTAKTIT

Palët në këtë marrëveshje bashkëpunimi do të caktojnë secila një person kontakti i cili/ e cila do të sigurojë që të gjitha palët të jenë të informuara në kohë dhe në mënyrë të plotë dhe të marrin vendime në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe përcaktimet në këtë marrëveshje bashkëpunimi. Këta persona do të jenë përgjegjës për zbatimin e marrëveshjes bashkëpunimit.

Në çastin e nënshkrimit të kësaj marrëveshje bashkëpunimi personat e kontaktit janë si vijon:

- Për Bashkinë Shkodër: Znj Rudina Kruja, specialiste pranë Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik.
- Për Organizatën “Të Ndryshëm & Të Barabartë”: Znj. Burbuqe Meçaj, Menaxhere Projekti.

Personat e kontaktit do të kenë detyrimin që:



- a) Të marrin pjesë në mbledhje të rregullta të rishikimit të mbarëvajtjes së alternativës së kujdesit për fëmijët;
- b) Të rishikojnë dhe të japin opinionet dhe rekomandimet e tyre për çdo dokument të prodhuar në kuadrin e kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi;
- c) Të informojnë pikën tjetër të kontaktit për çdo zhvillim apo ndryshim strukturor që prek përfituesit e kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi;
- d) Të kujdesen që në komunikimet mes palëve dhe veprimet e përbashkëta të respektohen parimet e kujdesit për fëmijët dhe grupet vulnerabël dhe sidomos parimet e pjesëmarrjes, mosdiskriminimit, interesit më të lartë të fëmijës dhe ruajtjes së konfidencialitetit e privatësisë.

Në rast të ndryshimit të njërit prej këtyre personave, pala e cila përfaqësohet prej këtij personi duhet të njoftojë me shkrim palën tjetër nënshkruese brenda një jave kalendarike për të dhënat e personit të ri të kontaktit.

NENI 9

ZBATIMI I MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT

Palët përgjigjen reciprokisht për përmbushjen e detyrimeve dhe kushteve të parashikuara në këtë marrëveshje bashkëpunimi, për të qënë partnerë në zbatimin e saj dhe të punojnë së bashku për realizimin me sukses të aktiviteteve të tij.

NENI 10

KOHËZGJATJA E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT

Kjo marrëveshje bashkëpunimi do të jetë e vlefshme për një periudhë 12 mujore, duke filluar nga data 01 Janar 2022 deri në datë 31 Dhjetor 2022, dhe mund të rinovohet me mirëkuptimin e palëve.

NENI 11

PËRFUNDIMI I MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT

Secila nga palët mund të përfundojë këtë marrëveshje në rastet kur:

- Mbaron afati i kohëzgjatjes i përcaktuar në këtë marrëveshje bashkëpunimi.
- Shkelen dispozitat e ligjit dhe të marrëveshjes së bashkëpunimit;
- Palët nuk i përmbahen qëllimit dhe objektit të marrëveshjes së bashkëpunimit;
- Për forcë madhore.



Për çdo rast, pavarësisht mënyrës së përfundimit, secila nga palët do të përmbushë të gjitha detyrimet që rrjedhin nga marrëveshja e bashkëpunimit deri në çastin e ndërprerjes së marrëdhënieve.

NENI 12

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet palëve zgjidhen me mirëkuptim, me bisedime ndërmjet tyre, deri në gjetjen e një zgjidhje të përbashkët, në të kundërt palët kanë të drejtën t'i drejtohen për zgjidhjen e tyre Gjykatës kompetente.

NENI 13

DISPOZITA TË FUNDIT

Palët përgjigjen reciprocisht për përmbushjen e detyrimeve dhe kushteve të parashikuara deri në fund të marrëdhënieve të kësaj marrëveshje bashkëpunimi, për të qenë partnere në zbatimin e saj, duke punuar së bashku për realizimin e veprimtarive.

Marrëveshja e bashkëpunimit mund të ndryshohet vetëm nëpërmjet një dokumenti me shkrim të nënshkruar nga palët.

NENI 14

HYRJA NË FUQI

Kjo marrëveshje bashkëpunimi hyn në fuqi nga data 1 Janar 2022. Hartohet në 4 kopje të barazvlefshme në gjuhën shqipe, nga dy kopje për secilën palë.

PËR
BASHKINË SHKODËR

KRYETAR

Zj. Voltana Ademi



PËR
“TË NDRYSHËM & TË BARABARTË”

DREJTORE EKZEKUTIVE

Znj. Mariana Meshi



8